



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202000377/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave të menjëherëshme për përshkrimin sipas legjisllacionit në fuqi dhe vënien në dispozicion të shoqërisë "Life" Shpk, të informacionit i cili konsiston në listën e barnave me çmimet "CIF/EXE", të miratuara për vitet 2014-2019.*

Drejtuar : **Zj.Geraldina PRODANI**
Sekretare e Përgjithshme
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

TIRANË

E nderuar zj.Prodani

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë Shoqëria "Life shpk", në përmbajtjen e së cilës pretendon shkëlqen e afateve të informimit dhe mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga ana e tyre, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ("MSHMS"). Specifikisht, në ankesën e saj kjo shoqëri parashtron pretendimin mbi mos vënien në dispozicion të saj nga ana Juaj, të listës së barnave me çmimet CIF/EXE, të miratuara për vitet 2014-2019.

Sa më sipër kjo Shoqëri kërkoi ndërmjetësimin tonë institucional për marrjen e një përgjigjeje nga ana Juaj.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare, në përputhje me nenin 2 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ka konstatuar se *ankesa e paraqitur plotëson kushtet për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, pasi ankuesi është shoqëri shqiptare, subjekti ndaj të cilit ai ankohet është organ i administratës publike, dhe objekti i ankesës është një veprim i paligjshëm i kësaj të fundit.*

Për sa më lart, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a, Institucioni ka vendosur t’a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë procesin përkatës të hetimit administrativ për sqarimin e plotë të rrethanave të paraqitura në ankesën e depozituar nga shoqëria.

Rrethanat e rastit:

Në shpjegimet e përcjella nga MSHMS-ja me shkresën nr.5588/1, dt.20.12.2019 për institucionin e Avokatit të Popullit citohet se:***MSHMS, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga kuadri ligjor specifik, ka filluar procesin e përpunimit të çmimeve të deklarurara nga subjektet farmaceutike për deklarimet e çmimeve të vitit 2020. Çmimet janë akoma në fazën e përpunimit të të dhënave.***

Pas përgjigjes Tuaj, Institucioni i Avokatit të Popullit informoi rregullisht shoqërinë mbi përmbajtjen e kësaj përgjigjeje dhe argumentave të parashtruara në të nga ana Juaj. Në analizë të përgjigjes Tuaj e asaj të shoqërisë, (pas vënies në dispozicion të shoqërisë nga ana jonë të përgjigjes Tuaj), Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerësoi si më poshtë:

Së pari, kërkesa e paraqitur nga shoqëria pranë MSHMS-së dhe më tej e paraqitur pranë Institucionit tone, në përmbajtjen e ankesës së tyre, ka referencë të saktë listat e barnave me çmimet CIF/EXE (në format Excel), **të miratuara për vitet: 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, dhe jo listën e vitit 2020.**

Pra, objekti i përgjigjes së datës 20.12.2019 me nr. prot: 5588/1 vënë në dispozicion të Institucionit të Avokatit të Popullit nga MSHMS-ja për shoqërinë, nuk është i njëjtë me objektin e kërkesës së shoqërisë, paraqitur pranë MSHMS-së. Dukshëm kërkesa e shoqërisë i referohet listës së barnave me çmimet CIF/EXE (në format Excel) për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, dhe jo listës së vitit 2020, të cilës i referohet MSHMS-ja në përgjigjen e saj.

Së dyti, informacioni i kërkuar nga shoqëria përbën një informacion të disponueshëm nga ana e autoritetit publik, MSHMS-së, sipas argumentimit të mëposhtëm:

Në VKM nr. 645 datë 01.10 .2014 “Për ngritjen dhe Funkcionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave”, ndryshuar me VKM nr. 615, datë 27.10.2017, VKM nr. 668, datë.10.10.2019 është përcaktuar mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave (KCB).

Ky komision mblihet brenda datës 5 nëntor të çdo viti, për të hapur zarfet e çmimeve të deklaruar të barnave sipas formularëve të miratuar. Pas verifikimeve dhe krahasimeve, KÇB miraton listën e përgjithshme me çmimet "CIF/EXE: e cila **brenda datës 31 dhjetor të cdo viti**, shpallet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, nga Drejtoria Farmaceutike, në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

Gjithashtu, kjo listë dërgohet zyrtarisht tek Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sipas detyrimeve që i ngarkon ligji, Agjencia përgatit dhe boton, **çdo vit**, regjistrin e barnave të regjistruara, çmimet e deklaruara CIF/EXE, listën e importuesve të autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit dhe kujdeset për përditësimin e të dhënave.

Pra, siç mund të vërehet lehtësisht, informacioni i kërkuar nga ana e shoqërisë, është informacion ekzistent e që disponohet nga MSHMS-ja, pasi në bazë të këtij informacioni operohet në fushën e farmaceutikës mbi bazë vjetore.

Për arsyet e cituara më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit, duke vlerësuar informacionin e kërkuar nga shoqëria si të disponueshëm nga autoriteti publik, MSHMS-ja, iu ridrejtua juve përkatësisht në datat 10.05.2020 dhe 08.07.2020, më kërkesat përkatëse për shpjegime, për dhënien e sqarimeve të mëtejshme mbi mospajisjen e shoqërisë me informacionin e kërkuar nga kjo e fundit.

Kërkesat tona, pas një periudhe të gjatë kohore, e në tejkalim të të gjithë afateve ligjore për trajtimin e kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, vijojnë të mbeten institucionalisht të pa adresuara nga ana Juaj.

Vlerësimi i institucionit të Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime në lidhje me ankesën e Shoqërisë:

Institucioni i Avokatit të Popullit, sjell në vëmendje se e drejta e informimit për dokumentet zyrtare është një e drejtë e individit e cila lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procedurave administrative. Për këtë arsye ajo është një e drejtë e mbrojtur dhe garantuar nga aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 19), Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10).

Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh për të drejtën e informimit, të cilat janë tregues i kuptimit që ka ky organizëm mbi këtë çështje, dhe që shërbejnë si udhërrëfyes për vendet anëtare për rregullimin e kësaj të drejte. Po kështu, nisur nga rëndësia parësore që e drejta e informimit ka për zhvillimin e demokracisë së një vendi, Këshilli i Evropës ka miratuar një Konventë të posaçme "Për aksesin në dokumentet zyrtare".

E drejta e informimit është sanksionuar edhe në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë, pasqyruar në Kushtetutën e RSH (neni 23) dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ligji nr. 119/2014, rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Institucioni ynë vlerëson se për të adresuar drejt e në përputhje me dispozitat ligjore "Për të drejtën e informimit", ankesën e shoqërisë, për mospajisjen nga

MSHMS-ja me informacion e kërkuar, është e nevojshme të arsyetohet qartë mbi:

- **disponueshmërinë e informacionit të kërkuar, nga autoriteti publik, MSHMS-ja;**
- **kualifikimin e informacionit të disponueshëm nga MSHMS-ja si informacion publik dhe i aksesueshëm nga shoqëria;**
- **përcaktimin e nivelit të aksesueshmërisë së informacionit, si tërësisht apo pjesërisht i aksesueshëm nga ankuesi pra shoqëria.**

Sa i përket disponueshmërisë së informacionit nga MSHMS-ja, në cilësinë e autoritetit publik, në VKM nr. 645 datë 01.10.2014, "Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave", ndryshuar me VKM nr. 615, datë 27.10.2017, VKM nr. 668, datë 10.10.2019, përcakohet qartë mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave (KCB).

Sipas, përcaktimeve ligjore rregulluese, ky komision mbledhet brenda datës 5 nëntor të çdo viti, për të hapur zarfet e çmimeve të deklaruara të barnave sipas formularëve të miratuar. Pas verifikimeve dhe krahasimeve, KÇB miraton listën e përgjithëshme me çmimet "CIF/EXE: e cila **brenda datës 31 dhjetor të çdo viti**, shpallet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, nga drejtoria farmaceutike, në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

Gjithashtu, kjo listë dërgohet zyrtarisht tek Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sipas detyrimeve që i ngarkon ligji, Agjencia përgatit dhe boton, **çdo vit**, regjistrin e barnave të regjistruara, çmimet e deklaruara CIF/EXE, listën e importuesve të autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit dhe kujdeset për përditësimin e të dhënave.

Pra, në dritën e parashikimeve ligjore të sipërcituara, **informacioni i kërkuar nga shoqëria në lidhje me listën e barnave me çmimet "CIF/EXE", të miratuara për vitet 2014-2019, përbën një informacion të disponueshëm nga ana e autoritetit publik, MSHMS-së**, për sa kohë që mbi këtë autoritet publik qëndron detyrimi ligjor për shpallejn në faqen zyrtare të tij, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, të listës së përgjithshme të barnave me çmimet "CIF/EXE.

Sa i përket kualifikimit të informacionit të disponueshëm nga MSHMS-ja si informacion publik dhe i aksesueshëm nga Shoqëria, ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në nenin 2, pika 2 të tij përcakton se: "*Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*". Më tej, në nenin 11 dhe 15 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", parashikohet se: "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit*".

Pra në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara, **kërkesa e shoqërisë plotëson kumulativisht kriteret e përcaktuara në nenin 2, 11 dhe 15 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe mbështetet në të drejtën e çdo**

personi për të kërkuar dhe aksesuar në mënyrën e parashikuar nga ligji, informacion e kualifikuar si publik e të disponueshëm nga autoriteti publik. Mbi autoritetin publik, MSHMS-në, bie detyrimi për kthimin e përgjigjes brenda afateve ligjore, të parashikuara në nenin 15 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Së fundmi, në lidhje me përcaktimin e nivelit të aksesueshmërisë së informacionit, si tërësisht apo pjesërisht i aksesueshëm nga shoqëria, theksojmë se pavarësisht sa parashtruar më lart, e drejta e informimit nuk është një e drejtë e pakufizuar, e pikërisht për këtë arsye ligjvënësi në nenin 15 të ligjit të sipërcituar, ka parashikuar shprehimisht edhe rastet e kufizimit të kësaj të drejte.

*Ligji për të drejtën e informimit ka disiplinuar edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion, në rastet kur autoriteti publik jep informacion të kufizuar në lidhje me sa kërkohet. Më konkretisht, në nenin 15 të ligjit "Për të drejtën e informimit", parashikohet se: *E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private, sekretin tregtar, të drejtën e autorit, patentat etj.**

*Në kuptim të parashikimeve të kësaj dispozite, **informacioni i kërkuar nga shoqëria nuk dëmton asnjë nga interesat e sipërcituara, por është një detyrim ligjor që rrjedh nga dispozitat e Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili garanton të drejtën për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.** Nisur nga sa parashtruar më sipër, pas përgjigjes së përcjellë nga MSHMS-ja e në analizë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar që rregullon të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, dhe të Kodit të Procedurave Administrative, Institucioni i Avokatit të Popullit konkludon sa më poshtë vijon.*

Qëndrimi i mbajtur nga ana e autoriteti publik, konkretisht MSHMS-ja, është në kundërshtim të hapur me parashkimet e dispozitave ligjore në fuqi "Për të drejtën e informimit", të cilat e ngarkojnë qartazi autoritetin publik me detyrimin për përcjelljen e informacionit të kërkuar, në rastet kur informacioni përmbush kriteret e një informacioni të disponueshëm e publik dhe nuk është objekt i kufizimeve ligjore në përcjelljen e tij. MSHMS-ja, nuk ka informuar as shoqërinë dhe as institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me kërkesën e vënies në dispozicion të listës së barnave me çmimet "CIF/EXE", të miratuara për vitet 2014-2019.

Institucioni i Avokatit të Popullit më tej vlerëson se, mosrespektimi i këtyre dispozitave nuk përbën ngushtësisht vetëm moszbatim të kërkesave të ligjit, por është edhe tregues i qasjes që ka institucioni në drejtim të praktikave të mira administrative, në përputhje me parimet e efikasitetit dhe ndihmës aktive që organi publik i jep palëve të treta.

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime

dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen;”

REKOMANDOJMË:

- ***Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në dispozicion të Shoqerisë “Life” Shpk, të informacionit i cili konsiston në listën e barnave me çmimet “CIF-EXE”, miratuara për vitet 2014-2019, në përmbushje të detyrimit ligjor që autoriteti publik, MSHMS-ja ka, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi “Për të drejtën e informimit”.***
- ***Botimin në faqen e MSHMS-së të listës dhe dërgimin e kopjes në formatin e duhur.***

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, lutemi na ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONER

Vilma SHURDHA